

FESTAT NË KORÇË

Korça është një nga shembujt më domethënës të qyteteve shqiptare që shfrytëzojnë turizmin vjetor, kryesisht atë malor dhe kulturor.

Me kapacitete të shtuara akomoduese dhe rritje të investimeve të brendshme, ky qytet po tenton që të tërheqë edhe më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj. Të katërta stinët kanë bukurinë e vet për një udhëtim në Korçë. Korça në dimër ofron një panoramë të mrekullueshme të qytetit nën petkun e bardhë. Interesante do të ishte Korça edhe në stinën e vjeshtës ku përveç se do të shijoni bukuritë e qytetit do të keni mundësinë të provoni frutat e mrekullueshme të zonës. Për të gjithë ata që preferojnë klimën malore, në verën e nxehtë, Korça dhe rrethinat e saj do t'ju ofrojnë freskinë, ajrin e pastër dhe një natyrë të mrekullueshme. Për më tepër Korça gjatë gjithë vitit ofron aktivitete të shumta kulturore, festa e panaire që do ta bënin akoma më të këndshëm qëndrimin tuaj në këtë qytet. Shumë interesante janë edhe ditët e festave si *Pashkët*, *Krishtilindjet*, *Karnavalet apo festa e birrës*, që shënojnë dhe numrin më të madh të vizitorëve në qytet.

KARNAVALET E KORÇËS



Karnavalet kanë filluar të festohen në Korçë para viteve '40, periudhë në të cilën jeta kulturore në këtë qytet ka qenë e larmishme. Megjithëse një festë pagane, Karnavalet më vonë festoheshin ditën e Ndjesave në muajin shkurt. Veç individëve të shumtë të veshur karnavale, kishte edhe grupe me kitara, këmbajka dhe maska butaforike si koka kafshësh dhe njerëzish. Karnavalet e Korçës morën një hov të madh pas krijimit të shoqërive

kulturore si “Rinia Korçare” etj. Në këtë periudhë karnavalet shoqëroheshin me mandolina, kitara dhe këngë humoristike.

Festimi i Karnavaleve u ndërpre pas vitit 60, për të rifilluar në kushte të tjera shoqërore pas vitit 90.

Korça është një ndër qytetet e para që rizgjoi traditën e karnavaleve duke krijuar në vitin 1992 Shoqatën e Karnavalit si pjesë e Shoqatës Kombëtare të Karnavalit Shqiptar. Në 10 prill të vitit 1994, në Korçë organizohet Festivali i Parë Ndërkombëtar i Karnavalit në Shqipëri. Një vit më pas organizohet Festivali i dytë Ndërkombëtar i Karnavalit me përmasa akoma më të mëdha. Që nga ky vit dhe deri në vitin 2008, grupi i Karnavaleve të Korçës është përfaqësuar në një sërë festivalesh ndërkombëtare të organizuara në vende të ndryshme europiane.

Eventi më i madh në Shqipëri

Festa e birrës në Korçë u themelua në vitin 2007, si një iniciativë e Bashkisë Korçë. Festivali është nderuar me çmimin e Turizmit nga Ministria e Kulturës në vitin 2010, për shkak të influencës që pati në rritjen e numrit të turistëve në rajon. Festa e birrës në Korçë, jo vetëm është një segment i rëndësishëm përse i përket tërheqjes së vizitorëve në rajon, por nga viti në vit ka promovuar dhe përforcuar imazhin turistik të rajonit.

Festa e Birrës, festa më e madhe në Shqipëri nderohet me Çmimin Shqiptar të Turizmit



Qyteti i serenatave gjallëron në të katër stinët me një kalendar të plotë eventesh që ushqejnë traditën dhe mbushin orët e lira të turistëve të shumtë. Nga stina e ringjalljes e deri tek ajo e Krishtlindjes qyteti zhurmon nga dritat, serenatat dhe njerëzit e mësuar tanimë me udhëtarë e bujtës që kërkojnë të rimarrin qetësi.



Panairi i pranverës

Kjo festë gjyros Pedonalen e qytetit me ekspozita, tezga tradicionale të

prodhimeve të baltës, koncerte për fëmijë e në mbremjë për të rritur dhe muzikë në qiell të hapur për ata që nuk kanë turp të kërcejnë se në Korçë kërcëhet, kur dëgjon serenata. Grupe të ndryshme muzikore performojnë në Pedonale gjatë dy javëve të panairit, duke provuar veten para publikut të rastësishëm dhe muzikëdashëve që lëkundën nën ritmet e notave të pentagramit. Nëse shkon në Korçë për këtë panair që zakonisht zhvillohet në fillim të Prillit, mund t'i dhurosh vetes si kujtim një punim interesant poçerie, karakteristike e artizanëve të zonës.



Festa e Lakrorit

Qyteti është i famshëm për gatimet tradicionale të tij ndër vite. Një prej simboleve të tryezes së korçarëve është lakrori, të cilit i dedikohet festa

me të njëjtin emër që mbahet çdo fund korriku. Festa e Lakrorit organizohet çdo vit nga Bashkia Korçë me qëllim gjallërimin e jetës turistike si edhe ruajtjen e traditës së gatimit tradicional. Gjatë ditës së festës amvisat tregojnë për kureshtarët përgatitjen e lakrorit që sigurisht përtpyen dhjetëra herë derisa ai të jetë gati për t'u shijuar. E veçanta e lakrorit është se gatuhet mbi zjarr të përgatitur enkas për të, që vendasit e quajnë pjekje në saç.



Festa e Mollës

Korça i ka me bollëk prodhimet e mollës shumëngjyrëshe e aromatike. Mollët e mbledhura në ferma të shumta të zonës që dallohen për këtë agrokulturë, krijojnë një mundësi argëtimi për turistët vendas dhe të huaj. Më shumë i ngjan një panairi ku çdo fermer synon të tërheqë në tezgën e tij modeste sa më shumë blerës që “hanë” me sy mollët e ëmbla ose majhoshe. Nuk mbaron këtu, sepse nga panairi mund të largohesh pasi të kesh blerë si dhuratë për të dashurit e tu një verë molle, reçel, liko apo prevede.

Javën e parë të Tetorit mund të bëheni pjesë e Festës së Mollës. Kulturat bujqësore të zonës po kthehen në atraksion turistik gjithashtu, sepse



“Ditët e Mios”

tillë është event i kolonias ndërkombëtare e piktorëve “Ditët e Mios”. Në fund të muajit tetor piktorë nga e gjithë Shqipëria afrohen në qytet për të ndjekur ose marrë pjesë në këtë event që mban emrin e piktorit të madh shqiptar Vangjush Mio. Korça është një hapësirë e kultivuar për artet pamore, që frymëzon të rinjtë që e gëzojnë talentin për të lodruar në kavalet. Në koloni gjatë viteve janë mikpritur edhe piktorë nga vende të ndryshme të botës.

Por turistët ushqejnë edhe shpirtin me eventet kulturore të qytetit, i cili shquhet për finesë dhe emra të mëdhenj në historinë e artit shqiptar. I



*Turizmi në këtë qytet ka dy pika të rëndësishme e të frekuentuara shpesh nga turistët, fshatrat **Voskopojë e Dardha**. Përveç klimës malore, me pyje të dendur me pisha e bredha, dhe prezencën e një peizazhi mbreslënës, turistët mund të gjejnë pjesë nga historia dhe trashëgimia e popullit shqiptar duke filluar nga periudha e sundimit Bizantin. Në Voskopojë gjenden një numër i konsiderueshëm kishash ortodokse dhe manastiresh që i përkasin kësaj periudhe. Gjatë dimrit të dy këto fshatra turistike ofrojnë pista skijimi për vizitorët e tyre.*

Atraksion ofrojnë edhe fshatra të tjerë ku mund të përmendim Boboshticën. Fshati shquhet për natyrën e mrekullueshme, pemët shekullore të manave, tavernat e shumta që ofrojnë një kulinari tradicionale, Kishat Ortodokse etj.

Buzë Liqenit të Prespës shtrihet fshati Zaroshkë. Bukuritë natyrore, mikpritja si dhe gatimet tradicionale e bejnë edhe më të vecantë këtë zonë që po frekuentohet gjithmonë e më shume.

Korça, qyteti i qeshur dhe plot jetë,

Mbetet padyshim destinacioni kryesor i turistëve për të kaluar momente të bukura në çdo kohë. Një udhëtim në Korçë për një fundjavë apo edhe disa ditë më shumë, do të ishte zgjedhja e duhur në të gjitha stinët e vitit.

E bukur dhe plot gjallëri, ku çdo vend, rrugicë apo dritare të buzëqesh dhe të fton të ndjesh ngrohtësinë dhe paqen që ky qytet ofron.

Mikpritja e korçarëve, serenatat si dhe gatimet tradicionale, krijojnë një panoramë të mrekullueshme për qytetin juglindor. Ajo që e bën Korçën të veçantë është qetësia ndërsa pamjet e qytetit ndryshojnë nga një lagje në tjetrën. Është pazari i ri i Korçës siç është quajtur që prej krimit të tij ai që më shumë tërheq turistët.

Ata janë çdo vit e më të shumtë, të bindur se në Korçë do të gjejnë diçka ndryshe nga çfarë kanë parë në qytetet e tjera.

Unikale për Korçën janë edhe **bujtinat** të cilat kanë një arredim të në një stili mjaft të veçantë e tradicional, gjë që sjell zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në cdo stinë.

Bujtinat janë ndërtesa me arkitekturë tradicionale, me dhoma të rehatshme dhe një dhomë pritjeje më atmosferë të ngrohtë pranë oxhakut.

Një ambjent relaksi ku mund të shijohet mëngjesi me specialitetet e zonës si petkat, trahanaja, e duke kaluar momente të këndshme në shoqërinë e çajit, kafes si dhe të ëmbëlsirave.

Turistët që i vizitojnë bujtinat e Korçës janë të shumtë, jo vetëm nga qytete të Shqipërisë por edhe nga vende të ndryshme të botës. Kënaqësia që ata marrin nga qëndrimi në ambjentet e bujtinave i bën ato më të preferuarat e tyre dhe për këtë shkak vendosin të rikthehen përsëri.

Kuzhina dhe pijet

Korça shquhet për gatime tradicionale e gjellë të shijshme. Është për t'u përmendur byreku ose lakrori me dy petë i pjekur në saç, gatimi i peshkut krap i cili gjendet në liqenin e Prespës, cironkat e famshme si dhe gatimi i kafshëve të egra dhe shpendëve. Gjellët karakteristike korçare janë: petanik me fasule, lakror, përvëlak i ardhur, lakror me qumësht, kërnacka etj. Vithkuqi përmendet për arrat dhe çajin me nam, për mishin e pjekur dhe bulmetin. Në Dardhë nuk duhet të ikni pa provuar të famshmin lakror me dy petë të pjekur në saç. Shumë të veçanta dhe të shijshme janë ligavecët e Dardhës,

kërmijtë, kërpudhat e vendit dhe baçori ose lakrori me miell misri. Nuk mund të lini pa provuar dhe birrën e famshme të Korçës, të parën birrë në Shqipëri.